



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Bordi

VENDIM

Nr. 240, Datë 02.11.2018

MBI

**FILLIMIN E PROCEDURËS PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË “ReNRGY TRADING GROUP” SH.P.K., NË VEPRIMTARINË E FURNIZIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE.**

Në mbështetje të nenit 16 dhe nenit 37, pika 2, gërma “ç” të Ligjit nr. 43/2015 “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, i ndryshuar, si dhe në zbatim të nenit 4, pika 1, gërma “d”; nenit 5, pika 1 gërma “d”; nenit 10, pika 3 të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” të miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s, nr. 109, datë 29.06.2016 dhe nenit 19, pika 1, gërma “a” të “Rregullores për Organizimin, Funksionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me Vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.06.2016, Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 02.11.2018, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, për fillimin e procedurës për licencimin e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike,

**Konstatohet se:**

- Shoqëria “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. Nr. 684 Prot, datë 23.10.2018, ka paraqitur kërkesën për licencim në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike.
- Aplikimi i shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., plotëson kërkesat e parashikuara nga ERE në “Rregulloren për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin dhe heqjen e licensave në sektorin e energjisë elektrike” si më poshtë:
  - Formati i aplikimit (neni 9, pika 1, )Plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacionin juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2), Plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacionin financiar dhe fiskal, (neni 9, pika 3). Plotësuar në mënyrë korrekte.
  - Dokumentacioni teknik për aktivitetin furnizimit të energjisë elektrike (neni 9 pika 4.7., pika 4.7.1). Plotësuar në mënyrë korrekte.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE,

**Vendosi:**

1. Të fillojë procedurën për licencimin e shoqërisë “ReNRGY Trading Group” sh.p.k., në veprimtarinë e furnizimit të energjisë elektrike, për një afat 5-vjeçar
2. Drejtoria e Licensimit dhe Monitorimit të Tregut, të njoftojë aplikuesin për Vendimin e Bordit të ERE-s.

**KRYETARI**

**PETRIT AHMETI**